



REPUBLIKA E SHQIPERISË

BASHKIA GRAMSH

SEKTORI JURIDIK DHE INTEGRIMIT NË BE

Nr. 7210 prot.

Gramsh, më 16 / 10 / 2017

K O N T R A T Ë

Nr. 7210 Date 16 /10/2017

PËR

KOLAUDIMIN E PUNIMEVE NË OBJEKTIN: “Sistemim-asfaltim Blloku i banimit në Lagjen Sporti 2”, bashkia Gramsh,

Sot më datë 16.10.2017 midis Bashkisë Gramsh (INVESTITOR) e përfaqësuar nga Kryetari Znj.Luljeta Dollani dhe Kolaudatorit te punimeve të caktuar në objektin. “Sistemim-asfaltim Blloku i banimit në Lagjen Sporti 2”, bashkia Gramsh, caktuar me Vendimin Nr. 153 date 16 /10/2017 ta Kryetarit të bashkisë , me përmbajtjen si më poshtë :

Baza ligjore.

Bazuar në ligjin nr.8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” kapitulli I III-të

UKM nr.3 I ndryshuar me UKM nr.4 date 17.05.2001 “Për një ndryshim në UKM nr.3 datë 15.02.2001 Për mbikeqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”. ndryshuar me UKM nr.7 dt 21.11.2001.

Dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative në lidhje me afatet , njoftimet, ankimet etj.

Dispozitat e Kodit Civil për siper marrjen.

Dokumentacioni administruar ne dosjen e zhvillimit te tenderit per objektin: : “Sistemim-asfaltim Blloku i banimit në Lagjen Sporti 2”, bashkia Gramsh.

NENI 1

Objekti i kësaj kontrate është Kolaudimi i punimeve në objektin: “Sistemim-asfaltim Blloku i banimit në Lagjen Sporti 2”, bashkia Gramsh,

NATASHA MYRTAJ
PROJEKTIM DREJTIA
KOLAUDIM

Kolaudatori per kete ndertim është punimeve ,ing.Natasha Myrtaj me licensë MK 0992/1

KREU I. DETYRIMET E KOLAUDATORIT

NENI 2

a)Kolaudatori cakton dhe njofton Bashkinë Gramsh për ditën kur do të kryejë procesin e kolaudimit të veprës të pakten 2-dite përpara .

b)Kolaudatori duhet të verifikojë me përgjegjësi :

1.Realizimi i objektit në përputhje me projektin,lejen e ndërtimit,standartet dhe rregullat teknike.

2.Realizimin e objektit në përputhje me kontratën e nënshkruar midis bashkimit të opertaoreve e konomike “Bajrami-N&Meteo”shpk,te perfaqesuar nga drejtuesi ligjor me prokurë z.Geri Zogu, dhe Investitorit Bashkia Gramsh.

3.Përputhjen e dokumentave me të dhënat nga matjet në dimension,formë,sasi dhe cilësi.

4.Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë ëe paraqitur në situacionin përfundimtar,si dhe sqarimet përkatëse në rastet e mospërputhjes.

NENI 3

Në përfundim të kolaudimit të veprës,hartohet procesverbali i kolaudimit i cili firmoset nga kolaudatori,sipërmarresi dhe mbikëqyresi i punimeve.

Procesverbali i kolaudimit duhet të ërmbajë :

1.Vëndin e ndërtimit.

2.Emërtimin e objektit dhe funksionin e tij.

3.Datën dhe prejardhjen e projekteve,si dhe ndryshimet e beëa ne to.

4.Vlerën e objektit.

5.Gjeneralitetet e sipërmarresit.

6.Afatin e ndërtimit.

7.Vlerën e shpenzimeve(sipas regjistrave të kontabilitetit).

8.Gjeneralitetet e kolaudatorit dhe specialiteti përkates.

9.Kohën e zgjatjes së kolaudimit.

10.Përshkrimin e verifikimeve të bëra mbi dokumentat dhe faktin,si dhe rezultatet e arritura.

NENI 4

Procesverbali paraqitet në 5(pesë) kopje të barabarta dhe pas regjistrimit 4(katër) kopje dërgohen në arshivën e Bashkisë Gramsh.

KREU II. DETYRIMET E INVESTITORIT(Bashkia Gramsh)

NENI 5

a)Të vëreë në dispozicion cdo dokument dhe informacion të nevojshem që kërkohet nga kolaudatori dhe që i shërben procesit të kolaudimit.

b)Të njoftojë drejtuesin e punimeve firmën sipërmarrese: bashkimit të opertaoreve ekonomikë “Bajrami-N”&”Meteo”shpk, për ditën kur do të kryhet kolaudimi dhe realizimi kontaktit të pare në bashkinë Gramsh.

c) Te shpërblejë kaloudatorin për punen e kryer sipas procedures të tenderit me procedurë:Blerje e vogël me 67 510(gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqindë e dhjetë)lekë pa Tvsh e zhvilluar më date 12.10.2017.

NATASHA MYRTAJ
PROJEKTIM DREJTIM
KOLAUDIM

KREU III. TE NDRYSHME

NENI 6

1. Bashkëlidhur kësaj kontrate si pjesë integrale e saj janë:

- Vendimi Nr. 153, dt 16 /10/2017

- Kopje e Licenses MK 0992/1

2. Gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është ajo e parashikuar nga dispozitat e Kodit Procedurës Civile.

Kjo kontratë hartohet në 5(pesë) kopje të barbara dhe pasi lexohet me zë të lartë me vullnetin e lirë të palëve firmoset si më poshtë

:

**KOLAUDATORI
ADMINISTRATORI**

ING. Natasha Myrtaj

**NATASHA MYRTAJ
NATASHA MYRTAJ
PRJËKTI M DREJTIM
KOLAUDIM**

**PËR BASHKINË GRAMSH
KRYETARI
Luljeta Dollani**

